



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1790 Prot.

Tiranë, më 11.07.2025

Lënda: Për realizimin e procedurave të konkurrimit të kandidatëve për mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës.

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

TIRANË, DURRËS, KORÇË, FIER, LEZHË

Për dijeni

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Alb-1001, "Rruga e Durrësit", Nr. 23, Tiranë

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 27.2.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", Urdhërin Nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës" në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe shkresën Nr. 5367/3 prot., datë 04.09.2024 "Mbi zbatimin Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës" në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ju përcjellim afatet për zhvillimin e procedurave të konkurrimit mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës.

Afatet për zhvillimin e procedurave të konkurrimit të kandidatëve për mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës

Nr	Veprimtaria	Afati	Përgjegjës
1.	Njoftimi për fillimin e procedurave të konkurrimit për mësues koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësues koordinator të këshillimit të karrierës.	14.07.2025	ZVAP

2.	Ngritja e komisioneve për përzgjedhjen e mësuesve koordinatorë në shkolla.	14.07.2025	ZVAP
3.	Dërgimi i dosjeve nga kandidatët në ZVAP	14.07.2025-18.07.2025	ZVAP
4.	Vlerësimi i dosjeve dhe shpallja e listës paraprake.	21.07.2025-22.07.2025	ZVAP
5.	Afati për ankimimet.	23.07.2025-24.07.2025	ZVAP
6.	Shqyrtimi i ankimimeve	25.07.2025	ZVAP
7.	Shpallja e listës përfundimtare, sipas renditjes për secilin kandidat.	28.07.2025	ZVAP
8.	Dërgimi i listës së mësuesve kordinatorë të përzgjedhur në shkollë. Informacioni përcillet në AKAP	30.07.2025-31.07.2025	ZVAP

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta Alla

